



GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Zenel Leku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Ndërmarrja Publike Komunale “Tregu” në Prishtinë, nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të cilën e përfaqëson me autorizim Albana Hoxha juriste, kundër të paditurit S. K., rr “....” komuna P., për pagesën e qirasë, vlera e kontestit 330€, në shqyrtimin kryesor-publik të mbajtur ne prani të ndërgjyqësve, me dt. 21.01.2015, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

MIRATOHET E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit Ndërmarrja Publike Komunale “Tregu” në Prishtinë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe DETYROHET i padituri S. K. nga P., që paditësit, në emër të borxhit të pa paguar për shfrytëzimin e stendes-lokalit nr.16, në Tregun-Anex Tregu i Gjelbert, për vitin 2008, t`ia paguaj shumën prej 330€, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 15€, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

### A r s y e t i m

Pala paditëse në padi dhe përmes përfaqësuese së autorizuar gjatë shqyrtimit kryesor ka theksuar se i padituri me palën paditëse ka qenë në marrëdhënie kontraktuese për shfrytëzimin e stendës - lokalit nr.16 në Tregun e Gjelberit në Prishtinë. Sipas marrëveshjes i padituri ka qenë i obliguar që qiranë ta paguaj për çdo muaj e më së voni gjer me datën 5 të muajt vijues. I padituri nuk ka përmbushur obligimet nga kontrata mbi qiranë edhe përkundër vërejtjes së fundit të dhënë nga pala paditëse. Nga këto arsye ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj palën e paditur që palës paditëse t`i paguaj shumën prej 330€, si borxh i mbetur pa paguar për vitin 2008. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I padituri në përgjigje në padi dhe gjatë seancave gjyqësore nuk e ka kontestuar që me palën paditëse ka qenë në marrëdhënie kontraktuese për shfrytëzimin e stendës së theksuar, por ka kundërshtuar pretendimin për pobrxhin e ngarkuar. Ka theksuar se nuk e din që i ka borxh palës paditëse ngase vazhdimisht ka paguar qiranë mujore për shfrytëzimin e stendës në fjalë. Ka deklaruar se edhe nëse i ka mbetur borxh palës paditëse për vitin 2008, borxhi në fjalë është parashkuar - vjetërsuar. Nga arsyet e paraqitura ka kërkuar që kërkesëpadia të refuzohet si e pabazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata ne procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të dt. 21.01.2015, beri administrimin e provave relevante materiale me leximin e Marrëveshjes për dhenjen me qira të stendes nr.33 dt. 23.01.2009, kontratën për rregullimin e borxhit me qiramarrësit (riprogramimit) nr.79 datës 23.01.2009 dhe vërtetimin e fundit nr.5 datës 04.06.2010.

Gjykata pasi vlerësoi provat e administruara e në kuptim të nenit 8 të LPK gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nuk ishte kontestuese që pala paditëse dhe i padituri ishin në marrëdhënie kontraktuese për gjatë vitit 2008 e për shfrytëzimin e stendës-lokalit nr.16 në Tregun e gjelbër –anex në Prishtinë. Këtë marrëdhënie kontraktuese palët e kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2009 e që dëshmohet nga marrëveshja nr.33 dt.23.01.2009.

Në bazë të kontratën për rregullimin e borxhit me qiramarrësit (ri programimit), nr.79 datë 23.01.2009, pala paditëse dhe i padituri janë marrë vesh ndërmjet veti që borxhi i mbetur pa paguar nga i padituri për shfrytëzimin e stendës së lartshënuar në shumën prej 480€ të paguhet me këste mujore nga 30€ në muaj.

I padituri, ashtu siç është parapa në marrëveshjen për ri programimin e borxhit, nuk e ka përmbushur detyrimin e pagimit të qirasë për vitin 2008 e që ka mbetur në vlerën prej 330€ për shfrytëzimin e stendës së lartshënuar, ashtu siç figuron në vërejtjen e fundit të dërguar nga pala paditëse nr.5 datës 04.06.2010.

Pala paditëse me vërejtjen e fundit nr.42 datë 04.06.2010 të paditurit ja ka bërë me dije se për shfrytëzimin e stendës së lartshënuar për vitin 2008, sipas marrëveshjes së qirasë dhe ri programimit të borxhit për vitin 2008, keni mbetur borxh në shumën prej 330, mirëpo i padituri nuk ka reaguar fare sipas vërejtjes së dërguar.

I padituri me asgjë nuk provoj para gjykatës te argumentoj te kundërtën nga ajo qe pretendon paditësi, e as te dëshmoj qe e ka paguar borxhin me te cilin ngarkohet. I padituri pretendon në parashkrim të kërkesëpadisë, mirëpo gjykata një pretendim të tillë e vlerëson si të pa bazuar nga fakti se vërejtja e fundit për pagimin e borxhit, të cilën e ka nënshkruar i padituri, është marrë me datën 04.06.2010 ndërsa padia lidhur me këtë çështje është dorëzuar me datën 18.11.2010. Nga kjo del se nuk ka kaluar afati i parapa në nenin 378 të LMD për parashkrim të kësaj kërkesë.

Me nenin 17 par.1 të LMD, është parapa që: *“Pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Ndërsa me nenin 262 par.1 të po këtij ligji është parapa që: *“Kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*.

Mbi bazën e kësaj e duke u nisur nga fakti se i padituri ka ngel borxh ndaj paditësit, pasi qe nuk ka paguar qiranë për shfrytëzimin e stendës-lokalit nr.16 ne Tregun e gjelbër, për vitin 2008, gjykata erdhi në përfundim që duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuar i padituri të detyrohet t'ia paguaj borxhin lartësi prej 330€, si shumë e kërkuar nga e autorizuara e paditësit, prandaj vendosi qe padinë e paditësit ta miratoj në tersi si të bazuar.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar ne dispozitën e nenit 450.1 te Ligjit për Procedurën Kontestimore sipas se cilës paditësit i pranohen shpenzimet për takse gjyqësore për padi 15€.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. 2459/10, dt. 21.01.2015

Gjyqtari,  
Zenel Leku

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes se te njëjtit Gjykatës se Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.